ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Prishtinës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-3272-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **"119 Programi për ofrimin e shërbimeve të energjisë në ulje të shpenzimeve financiare në Komunën e Prishtinës sipas UA nr.06-2021".**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

LCE SHPK

Rr. "Ferid Curri" pn

Prishtinë *10000*

048 552 444 *(Numri i Faks-it)*

Arsim Kuliqi

info@lce-rks.com

19.12.2024 *(Nënshkrimi dhe vula)*

Lighting Consulting Engineering LCE SH.P.K Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për Kontratë - 04.04.2024 B12 Procesverbali i Hapjes së Tenderëve – 06.06.2024 B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK – 03.12.2024 Kërkesa për rishqyrtim – 08.12.2024 Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – 16.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. Kërkesa për rishqyrtim – 08.12.2024 Vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim – 16.12.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK ka shkelur nenin 59 par. 4 lidhur me nenin 1 dhe 7 të LPP pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është administrativisht i papërgjegjshëm dhe për këtë arsye është dashur që i njëjti të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë. Në vijim do të prezantohen pretendimet tona ankimore të mbështetura në argumentet përkatëse faktike dhe juridike:

Pretendimi nr. 1 – tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të dhëna teknike, datasheet ose të ngjashme për pozicionin 12 "*Furnizimi, transporti dhe montimimi i Koncentratorit ose e ngjajshme me karakteristika minimale ose e avancuar:*
RTU200Z ose e ngjajshme Zigbee 2.4G, ekran LCD.
- Koncentrator, një urë komunikimi ndërmjet serverit (GPRS/ 3G/4G/Ethernet) dhe LCU (nga Zigbee), përditësohet nga OTA, 96-500VAC, 50~60Hz,≥2W, ≥IP54, ≥-30°C~+70°C.
- Mikro-kontrollues i shkallës industriale 32-bit me performancë të lartë CPU ARM9
- Bazuar në sistemin Linux ose te ngjashem i cili është shumë i besueshëm platformë
- Me 10/100m Ethernet, RS485, USB interface;
- Mbështet metodat e komunikimit në distancë GPRS dhe Ethernet
- Përmirësimi lokal/në distancë: porta serike/disku USB,Ethernet/GPRS;
- Mund të lexojë energjinë elektrike nga distanca me inteligjencë të integruar metra ose matës të jashtëm
- 4 DO, 8 DI (6DC IN+2AC IN).
- Bateria Fuli ose e ngjajshme 12V/12Ah/20hr
- Induktorë të dyanshëm pasje për faza (mutual inductor)." të paramases.
Këto të dhëna teknike janë kërkuar në *Kriterit mbi mundësitë teknike dhe/ose profesinale pika 15 në FDT,* ku në mënyrë të specifikuar kërkohet "***15. Operatori Ekonomik (Shërbyesit e energjisë) duhet të paraqes specifikat teknike për kocentratorin i cili komunikon me trupat ndriçues përmes Lamp Kontrollerit. Kocentratori duhet te jetë i Certifikuar me standarden CE.***"

Pretendimi nr. 2 – tenderuesi i rekomanduar nuk ka plotësuar në mënyrën e duhur deklaratat nën betim. Kjo përbën kusht administrativ prandaj tenderuesi i rekomanduar është dashur që eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë. Më konkretisht

mungon nënshkrimi i OE në rubrikën e dedikuar për nënshkrim. Kësisoj deklarata nën betim nuk është e vlefshme dhe nuk duhet pranuar nga AK. Kjo vlen për të dy deklaratat e të dy anëtarëve të GOE. Si dëshmi për këtë fakt shih fotot në vijim:

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	**" FULI INŽENIRING " SH.P.K.**
Adresa e plotë:	Suhareke
I përfaqësuar nga:	
Emri	Afrim Elshani
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	03.06.2024
Vula	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara "FULI INŽENIRING" 811034660 Leshan - Suhareke

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	**" GREGORIC ELEKTROMEHANIKA d.o.o. Dega në Kosovë "**
Adresa e plotë:	Bashkim Fehmiu, 24 , Prishtine
I përfaqësuar nga:	
Emri	Ziga Gregoric
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	03.06.2024
Vula	GREGORIČ ELEKTROMEHANIKA d.o.o. Zalokje 17, 8233 Mirna www.elektromehanika.si

Pretendimi nr. 3 – Deklaratat për formimin e grupit të operatorëve ekonomik nuk është hartuar sipas formularit të KRPP dhe në përputhje me RRPP në fuqi. Në analizohet deklarata për themelimin e GOE lehtësisht mund të konfirmohet se tenderuesi i rekomanduar ka improvizuar dhe aspak nuk ka respektuar mostrën e deklaratës të publikuar në eprokurim. Ky fakt përbën po ashtu kusht administrativ prandaj tenderuesi i rekomanduar është dashur që eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë. Në vijim do të gjeni fillimisht deklaratën sikurse është dashur që të përpilohet sipas formatit të KRPP dhe më pas e gjeni në foto deklaratën e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar.

Aneksi XX **DEKLARATA PER THEMELIM TE GRUPIT**

Të nënshkruhet nga secili anëtarë i grupit/apo konzorciumi që aplikon

Për: [*shëno emrin e AK*]
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: [*shëno emrin e Grupit te OE*]
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: [*shëno titullim e Aktivitetit te prokurimit*]

Numri i Prokurimit: [*shëno numrin*]

Hyjnë ne bashkëpunim si Grup i Operatoreve Ekonomik , për qëllim të këtij tenderi me titull: [*shëno titullim e Aktivitetit te prokurimit*] me numër te prokurimit [*shëno numrin*].

Ne, Grupi i Operatorëve Ekonomik në përbërje të anëtarëve të grupit:

I. [ ]
Shëno emrin e anëtarit të grupit - Liderit *Shëno adresën*

dhe

II. [ ]
Shëno emrin e anëtarit të grupit *Shëno adresën*

KONSORCIUM NDERMJET DY PALEVE – **Joint Venture**

1. Si kompani Lider

" FULI INŽENIRING " SH.P.K me nr të Biznesit **811034660** e themeluar në Prishtinë, që e përfaqëson Afrim Elshani, DREJTOR.

2. Kompania e Dyte – Partner
" GREGORIC ELEKTROMEHANIKA d.o.o. Dega në Kosovë " me nr të Biznesit **812166115** e themeluar në Prishtinë si Degë, që e përfaqëson Ziga Gregoric , DREJTOR

Titulli: 119 Programi per ofrimin e sherbimeve t eenergjise ne ulje te shpenzimeve financiare ne Komunen e Prishtines SIPA UA 06 2021.
Nr i prokurimit: 616-24-3272-2-1-1

KUVENDI KOMUNAL I PRISHTINËS

Të cilet më tutje do të quhen si Anëtarë të Konsorciumit, kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Anëtarët e konsorciumit janë njëzëshëm për themelimin e grupit:

Nga sa u tha më sipër kërkojmë nga OSHP që të merr këtë:

VENDIM
MIRATOHET si e bazuar Ankesa e LCE Sh.P.K. ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i dt. 03.12.2024 ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të caktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*